



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth & Sports

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale

Agencija za Upravljanje Spomenika i Memorijalnih Kompleksa

Agency for the Management of Monuments and Memorial Complexes

DATË/DATUM/DATE	07.06.2024
PËR/ZA/TO:	Z. Hajrulla Çeku , Ministër në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
CC:	Z. Xheladin Krasniqi , Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Znj. Nora Arapi , Këshilltare e Ministrit, Kabineti i Ministrit
NGA/OD/FROM:	Imer Hakaj , Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale/AMMKM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës së Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për periudhën Janar-Maj 2024 dhe projektet për realizim gjatë periudhës Qershor - Dhjetor 2024

I nderuar ministër Çeku,

Duke shprehur falenderimin dhe mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e projekteve dhe punëve në AMMKM, në vijim gjeni Raportin e punës të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale i cili përfshinë të dhënat për realizimin e buxhetit dhe projektet kapitale për periudhën Janar-Maj 2024 dhe projektet për realizim gjatë periudhës Qershor - Dhjetor 2024.

Tabela nr. 1. Shpenzimi i Buxhetit Janar – Maj 2024

Kategoria Ekonomike	Buxheti fillestar	Të shpenzuara	Mjetet të zotuara	% e realizuar
Paga dhe mëditje	204,168.00	72,111.94	0	35%
Mallra dhe shërbime	640,000.00	242,153.51	65,594.18	38%
Shpenzime komunale	63,000.00	34,024.78	0	54.0%
Kapitale	5,390,000.00 (totali) 3,190,000.00	257,444.52	139,381.16	8%
Grant i donatorëve të brendshëm	5,000.00	0	0	0
Kompleksi Memorial Adem Jashari Prekaz	2,000,000.00	0	0	Procedura e tenderimit nga MKRS. Buxheti konsiderohet i realizuar pasi që mjetet janë të kontraktuara.
Kompleksi Memorial Masakra e Reçakut, Shtime	200,000.00	0	0	Në proces të shpronësimit dhe buxheti për këtë projekt konsiderohet si i realizuar.
Totali Përqindja e llogaritur me buxhet të kontraktuar nga Kompleksi Memorial Adem Jashari dhe Kompleksi Memorial Masakra e Reçakut	6,297,168.00	2,805,731.75	0	45%
Totali:	6,297,168.00 (totali) 4,097,168.00	605,734.75	204,975.34	15%

Sqarim: Projekti Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, Prekaz, ka vlerën 2,000,000.00€ dhe AMMKM ka vetëm buxhetin për realizim, jo procedurën dhe nuk varet nga AMMKM vonesat në realizim të buxhetit. Prandaj shuma e projekteve në tabelë janë paraqitur totali si buxhet dhe pa shumën e projektit të Kompleksit Memorial “Adem Jashari”.

Në këtë mënyrë është vepruar edhe me projektin Kompleksi Memorial “Masakra e Reçakut” , Shtime dhe përqindja e realizimit është llogaritur pa buxhetin e tyre.

Projektet kapitale në proces të realizimit për gjatë viteve 2022, 2023 dhe 2024

- Konservimi dhe Ndertimi i Kompleksit Memorial-Historik-Shtabi i ZOD-it të UÇK-së dhe Muzeut në Gillogjan, Faza III buxheti i përgjithshëm i planifikuar për realizimin e kësaj kontrate është **2,314,764 .00€**, realizimi është në shumë prej **912,414.91€**;

Projektet kapitale në proces të realizimit për gjatë viteve 2023, 2024 dhe 2025

- Projekti me titull “Ndërtimi i “Memorialit të Martirëve në Çikatovë të Re ” – Drenas-Ritender Çikatovë e Re”; (2023 vazhdon deri në vitin 2025)
- Projekti me titull “Renovimi i Memorialit të Dëshmorëve dhe Martireve në Grabanicë, Klinë”; (2023 vazhdon deri në vitin 2025)
- Projekti me titull “Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorëve të UÇK - së ”, Mitrovicë; (2023-2024).
- Projekti me titull “Konservimi dhe Restaurimi i Disa Objekteve të Luftës së UÇK - së dhe Objekteve ku Janë Kryer Masakrat”; (2023-2024) (Konservimi dhe Restaurimi i Xhamisë së Brojë-Skenderaj (në proces të konsultimit me Institucionet e Trashëgimisë Kulturore), Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë së Familjes Lipa Studenicë – Istog (në diskutim me familjen për vazhdimin e punimeve sipas kontratës), Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë së Familjes Gërzhaliu Vushtrri (në diskutim me familjen për vazhdimin e punimeve sipas kontratës), Konservimi dhe Restaurimi i Shpellës ku ka Shërbyer si Spital i UÇK-së Petrovë-Shtime, Trajtimi i Gjashtë Lisave në Likoshan, Konservimi dhe Restaurimi i Mullirit I në Lladroc-Malishevë dhe Konservimi dhe Restaurimi i Mullirit II në Lladroc, Malishevë)
- Projekti me titull “Vendosja e Pllakave Informuese ne Komplekse dhe Memoriale për Nevojat e AMMKM-së Faza e -I-“; (2023-2024)
- Projekti me titull “Ndërtimi i Shtatores së Dëshmorit “Rifat Mziut” Marinë – Skenderaj – Ritender”; (2023-2024) (+10,000.00€ buxhet shtesë për vitin 2024)
- Projekti me titull “Ndërtimin e Varrezave të Veteranëve në K.M në Kleçkë (K.M “ZIV Shtabi i Përgjithshëm Kleçkë dhe Divjakë” Malet e Berishës”. (2023 - 2024)
- Projekti me titull “Konservimi i Shtëpisë ku është kryer Masakra në Poklek të Vjetër Drenas-Muzealizimi” në vlerë prej 117,887.88 euro. (2023-2024, e përfunduar).

Projektet kapitale të realizuara dhe në proces të realizimit për gjatë vitit 2024

- Projekti me titull “Ndërtimi - Muzealizimi i Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së në Penuhë - Komuna Podujevë” në vlerë prej 98,499.13€;
- Projekti me titull “Intervenim Emergjent në Projektin e Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së, Ngucat Malishevë” në vlerë prej 5,937.16 €
- Projekti me titull “Zhvarrosja dhe Rivarrosja e Heronjve, Dëshmorëve, Martirëve dhe Veteranëve në Komplekset Memoriale dhe Varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve” në vlerë prej 300,000.00€;
- Projekti me titull “Ndërtimi-Ekzekutimi i Punimeve në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve të UÇK - së në Marinë, Skenderaj - faza -II- në vazhdim” në vlerë prej 100,000.00€;
- Projekti me titull “Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të Brigadës 136 Rugova në Pepaj – Rugovë” në vlerë prej 100,000.00€ (60,000.00€ për vitin 2024 dhe 40,000.00€ për vitin 2025)
- Projekti me titull “Ndërtimi-Ekzekutimi i punimeve në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve të UÇK-së në Marinë, Skenderaj Faza e II në vazhdim” (është inicuar procedura).
- Projekti me titull “Ndërtimi Memorialit të Dëshmorëve të Brigadës 136 në Pepaj Rugovë” (është inicuar procedura).
- Ndërhyrjet emergjente në Kompleksin Memorial “Beteja e Koshares” , Koshare (është inicuar procedura).
- Ndërtimi i memorialit të katër dëshmoreve në Komunën e Kaçanikut (në proces të hartimit të projektit);
- Ndërtimi i shtatoreve të vëllëzerve Gërvalla dhe Kadri Zekës – Ferizaj; (është hartuar projekti dhe nga AMMKM është dorëzuar projekti në MKRS).
- Ndërtimi i Memorialit të dëshmorëve dhe martirëve në Terstenik- Drenas, faza e II-të (në proces të hartimit të projektit)
- Memoriali i Masakrës së Verbocit Drenas (në proces të hartimit të projektit)
- Gjatë procesit të shpronësimit në K.M Masakra e Reçakut, Reçak, Shtime, në këtë periudhë raportuese është arritur që të revidohen elaboratet e shpronësimit dhe janë dorëzuar në MMPHI – në Departamentin e Shpronësimit. Për fazën e parë shpronësimi i shtëpisë së mësuesit Sadik është nxjerr Vendimi i parë për shqyrtim të kërkesës Nr. 05/182 të dt. 10.01.2024 dhe është mbajtur debati publik me dt. 30.01.2024 dhe Vendimi i dytë preliminar Nr. 05/193 të dt. 13.03.2024.
- Faza e dytë që përfshin të gjitha pronat e tjera brenda këtij kompleksi memorial është arritur të nxirret Vendimi i parë për shqyrtim të kërkesës me Nr. 12/206 të dt. 21.05.2024. Debati publik me pronarët dhe qytetarët do të mbahet më dt.18.06.2024 në Shtime.

Tabela nr. 2. Shpenzimet në kategorinë investime kapitale Janar – Maj 2024

Kodi i Projektit	Emri i Projektit	Vlera e shpenzuar
18693	Renovimi i Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve në Komunën e Suharekës, Bashkëfinancim me Komunën	50,000.00
14652	Konservimi dhe Ndertimi i K.M. -Historik-Shtabi i ZOD-it të UÇK-së dhe Muzeut në Gillogjan, Faza III	133,712.90
18299	Konservimi i Shtepisë ku është kryer Masakra në Poklek të Vjetër Drenas	40,441.50
14649	Intervenim Emergjent në Projektin e Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së, Ngucat Malishevë	5,937.16
14657	Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale	2,352.96
19178	Shtatorja e Rifat Mziut, Skenderaj	25,000.00
Totali		257,444.52

Sfidë për AMMKM-në për periudhën Qershor – Dhjetor 2024 është mungesa e buxhetit të mjaftueshëm në kategorinë mallra e shërbime dhe obligimeve kontraktuale të shumta për mirëmbajtjen e komplekseve memoriale. Deri më tani AMMKM mirëmban 48 memoriale (përfshirë varreza të dëshmorëve dhe martirëve, komplekse memoriale, lapidar) dhe buxheti i kërkuar shtesë për këtë periudhë (qershor-dhjetor) është përafërsisht: 300,000.00€.

Stafi / rekrutimi

Sipas Ligjit nr. 08/L-260 për buxhetin e vitit 2024, AMMKM ka 22 pozita, prej tyre aktualisht ka 20 pozita të plotësuara dhe dy pozita të lira.

Projektet të cilat janë në buxhet për vitin 2024 për të cilat AMMKM kushtëzohet për realizim nga institucionet e tjera kompetente:

1. Projekti me titull “Kompleksi Memorial “Demë Ahmeti”, Podujevë, i cili nuk është realizuar për shkak që për këtë projekt është në vazhdim procesi gjyqësor;
2. Projekti me titull “Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit “Adem Jashari” në Malishevë” në koordinim me Komunën e Malishevës për realizimin e këtij projekti;
3. Projekti me titull ”Kulla e Heroit “Fehmi Lladrovci” Drenas, në koordinim me Komunën e Drenasit për realizimin e këtij projekti.